



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2025

Lënda: Bisedime përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Kledian Llaho.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Për kompetencë: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe propozimet e palëve, si dhe provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 17.2.2023 dhe parashtrimeve të depozituara në seancat gjyqësore të datave 11.7.2025 dhe 23.7.2025, në mënyrë të përmbledhur vlerëson si vijon:

I. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Lidhur me pasurinë Depozitë në “*** Bank”, në vlerën 5.000.000 lekë, sikurse është trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 17.2.2023 dhe në parashtrimet e seancës gjyqësore datë 11.7.2025, rezulton se si burim krijimi për depozitën bankare në “*** Bank”, kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e pasurisë “*apartament me sip 105 m²*”, ndodhur në lagjen nr. **, Durrës.

1.1 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vëren se subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë “*apartament me sip 105 m²*”, të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer si burim krijimi për depozitën bankare në shumën 5.000.000 lekë të deklaruar në Deklaratën Vetting, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe nuk ka paraqitur akte të reja për të provuar të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

1.2 *Lidhur me burimin “kontribut i nënës” në shumën 600.000 lekë*, vlerësojmë se, edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor në Kolegj, mbeti e provuar se:

1.2.1 Ky burim krijimi nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën Vetting ku subjekti ka deklaruar burimet e krijimit të pasurisë “*apartament me sip 105 m²*” dhe as në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014, ku parashikohej qartësisht që subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre.

1.2.2 Znj. ***,***. (nëna e subjektit) nuk ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar me burime të ligjshme shumën 600.000 lekë, deklaruar dhënë subjektit të rivlerësimit. Sikurse është trajtuar gjerësisht në ankim dhe në parashtrime, të ardhurat e dokumentuara të znj. ***, ***, deri në prill 2011, janë të ardhurat nga pensioni në vlerën rreth 700.000 lekë¹ dhe të ardhurat nga shitja e pasurisë me nr.19/5², tokë arë me sipërfaqe 4.680 m², ku pjesa takuese e nënës së subjektit është 50.000 lekë. Gjithashtu, subjekti deklaroi se nëna e tij ka realizuar të ardhura sipas deklarës noteriale nr. *** rep., datë **.10.2004 nga shitja e një pasurie toke arë me sipërfaqe 1.500 m², ku pjesa takuese e nënës së subjektit është në vlerën 50.000 lekë. Sa më sipër, rezulton se edhe nëse marrim në konsideratë të ardhurat nga shitja e pasurisë tokë arë më sipërfaqe 1.500 m² për të cilën nuk është depozituar kontratë shitblerje, të ardhurat totale të nënës së subjektit llogariten në vlerën 800.000 lekë.

1.2.3 Sa i takon shpenzimeve, rezulton se vetëm shpenzimet e jetesës për një person (nëna e subjektit) për periudhën 2003- prill 2011, llogariten në vlerën rreth 1.080.000 lekë. Gjithashtu gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me kursimet e prindërve është mbuluar dhe diferenca në shumën 300.000 lekë që ka shërbyer për shlyerjen e apartamentit blerë nga nëna e tij në vitin 2007³.

1.2.4 Sa më sipër analizuar, rezulton se nëna e subjektit nuk ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të dhënë subjektit shumën 600.000 lekë. Çmujmë të theksojmë se edhe në konsideratë të deklarimeve të subjektit se shpenzimet e jetesës së znj.***.***, janë mbuluar prej tij⁴, përsëri rezulton se duke zbritur nga shuma e të ardhurave të paktën shumën 300.000 lekë që ka shërbyer për shlyerjen e apartamentit edhe duke supozuar që nuk ka kryer asnjë shpenzim tjetër gjatë këtyre viteve, përsëri rezulton se ajo nuk mbulon me burime të ligjshme shumën 600.000 lekë.

1.3 *Lidhur me burimin ndihmesë e vëllait nga punësimi në Itali, në shumën 7.000 euro*, vlerësojmë se edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor në Kolegj, mbeti e provuar se në Deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për pasurinë “*apartament më sip. 105 m²*” ndihmesë nga vëllai i punësuar në Itali, pa specifikuar vlerën e kësaj ndihme, ndërsa në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014, subjekti nuk e ka deklaruar këtë burim krijimi.

¹ Referohuni informacionit të përcjellë nga ISSH-ja me shkresat nr. ***/** prot., dhe nr. ***/** prot., datë **.6.2022.

² Kjo pasuri rezulton të jetë shitur me kontratë shitblerje nr. ***/***, datë **.10.2004 nga 4 bashkëpronarët, në shumën totale 200.000 lekë.

³ Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në përgjigje te pyetësorit nr.3.

⁴ Referohuni përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr.3

1.3.1 Nga analiza financiare e kryer për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të shumës 7.000 euro, Komisioni ka konstatuar pamjaftueshmëri në vlerën -1.668 euro⁵.

1.3.2 Në ndryshim nga Komisioni, çmujmë se shpenzimet e jetesës për familjen e z. ***. ***, në këtë analizë, duhen llogaritur sipas të dhënave të Eurostat-it⁶, për një familje me 4 anëtarë, në përputhje me përbërjen familjare të vëllait të subjektit, çka do të çonte në një pamjaftueshmëri në një vlerë më të lartë se ajo e konstatuar nga Komisioni dhe si rezultat në pamundësi financiare për ti dhënë subjektit të rivlerësimit shumën e pretenduar.

1.4 *Lidhur me burimin ndihmesë e prindërve të bashkëshortes në shumën 1.500.000 lekë për blerje apartamenti dhe 7.000 euro për arredim*, vlerësojmë se edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor në Kolegj, mbeti e provuar se në Deklaratën Vetting, dhe në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për “*apartamentin me sip. 105 m²*” ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes, por në asnjërën prej këtyre deklaratave, nuk ka deklaruar sa është shuma e ndihmës së dhënë prej tyre. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor dhe i pasaktë në deklarimet e tij lidhur me shumën, kohën e dhënies të këtyre shumave nga prindërit e bashkëshortes dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e shumës 1.500.000 lekë.

1.4.1 Sa i takon të dhënave financiare të prindërve të bashkëshortes së subjektit, sikurse është trajtuar në ankim dhe parashtrimet e seancës gjyqësore datë 11.7.2025, vërejmë se pas shitjes së apartamentit në vitin 1997, ata kanë kryer një investim për ndërtimin e një objekti tregtar hotel/restorant në qytetin e Sarandës, në një vlerë të konsiderueshme. Prindërit e bashkëshortes së subjektit, kanë marrë disa herë kredi bankare në bankat e nivelit të dytë në funksion të aktivitetit të tyre tregtar. Sa i takon të ardhurave të realizuara prej tyre nga ushtrimi i aktivitetit tregtar, referuar të dhënave të administruara në dosjen e ILDKPKI-së deri në vitin 2013⁷, kur është dhënë dhe shuma 7.000 euro, rezulton se janë dukshëm në një masë të tillë që nuk mundësojnë mbulimin me burime të ligjshme të shpenzimeve për jetesë, kredi dhe për t’i dhënë subjektit dhe personit të lidhur shumën 1.500.000 lekë dhe 7.000 euro.

1.5 Sa më sipër, vlerësojmë se në këto rrethana fakti, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit as në deklaratën Vetting dhe as në deklaratën para fillimit të detyrës, nuk ka specifikuar dhe/ose deklaruar vlerat e shumave të dhëna si kontribut nga nëna, vëllai dhe prindërit e bashkëshortes, si dhe ka deklarime kontradiktore lidhur me burimin e krijimit dhe kohën e marrjes së ndihmës financiare nga prindërit e bashkëshortes, pamundësohet dhe kontrolli i burimit të deklaruar “kursime familjare”, me kontribut të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes.

⁵ Referohuni analizës financiare të Komisionit në fq. nr.16 të vendimit. Nga aktet në dosje duket se Komisioni ka kryer analizën financiare për vëllain e subjektit për periudhën **3.2011-**.8.2011, pasi nga hetimi administrativ ka rezultuar se ky i fundit ka paguar dy këste për blerjen e apartamentit në pronësi të tij deri në datë **3.2011 dhe si rezultat nuk ka patur mundësi kursimi në këtë datë.

⁶ Referuar të dhënave të Eurostat-it, shpenzimet e jetesës në shtetin Italian për një familje të përbërë nga 4 anëtarë për 6 muaj llogariten në vlerën rreth 10.000 euro.

⁷ Referohuni informacionit të përcjellë nga: Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë me shkresën nr. ***/** prot., datë **7.2017 dhe nr. ***/1 prot., datë **.8.2017; Bashkia Sarandë me shkresën nr. ***/** prot., datë **7.2017; dhe ISSH-ja me shkresën nr. ***/** prot., datë **7.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

1.6 Në përmbledhje të sa më sipër, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton i besueshëm në kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi është në kushtet e deklarimit kontradiktor, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe çon institucionet e rivlerësimit në pamundësi për të verifikuar se cilat ndër deklarimet e subjektit të rivlerësimit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e krijimit të pasurisë së tij.

1.7 Në përfundim të kontrollit të pasurisë, vlerësojmë se rrethanat e dala nga hetimi administrativ mbi këtë kriter duhet të vlerësohen në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

II. Për kontrollin e kriterit të figurës

2. Lidhur me këtë shkak ankimi, sikurse është trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 17.2.2023 dhe në parashtrimet e seancës gjyqësore datë 11.7.2025, rezulton se Komisioni, pasi ka administruar raportin e kontrollit të figurës me nr. *** prot., datë **.10.2017, përgatitur nga DSIK-ja për subjektin e rivlerësimit z. Llaho, ka kërkuar përditësimin e të dhënave nga organet ligjzbatuese si dhe ka verifikuar informacionet konfidenciale pranë këtyre organeve, duke administruar për këtë qëllim dhe dosjet përkatëse të disa procedimeve penale.

2.1 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit⁸, vlerëson se nga analiza e shkeljeve të konstatuara dhe informacioneve të përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, përftohen indicie dhe perceptime të rëndësishme se integriteti i subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, do të duhej të konsiderohej me mangësi.

3. **Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë **.6.2019**, për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës 11.7.2025, *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe nuk ka paraqitur akte të reja për të provuar të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

3.1 Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në analizë të situatës faktike të këtij rasti, mbeti e provuar se prej datës së vendimit gjyqësor, nr. *** datë **.6.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, momenti i vleftësimit të arrestit në flagrancë dhe caktimit të masës së sigurisë “*arrest me burg*” ndaj shtetasve të dyshuar në kuadër të procedimit penal nr. ***/2019, e deri në datë **.2.2020, moment kur gjyqtari paraprak i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. *** datë **.02.2020, ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim me akuzat përkatëse, kanë kaluar më shumë se 8 muaj.

3.1.1 Gjatë kësaj periudhe, veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit kanë rezultuar jo efektive, të paplota dhe jo të gjithanshme. Konstatimi i mungesës së dilijencës për të kryer në afate të arsyeshme veprimet hetimore të duhura dhe realisht të lidhura me akuzën në ngarkim të të arrestuarve, ka pasoja në ngritjen e akuzës duke kërkuar edhe ndryshimin e cilësimit juridik të veprave penale. Sa më lart konstatuar, bazohet në arsyetimin e vendimit gjyqësor nr. ***/2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

⁸ Referohuni vendimit (JR) nr. 16/2021 të Kolegjit, prg. 92.

Vlorë, ku argumentohet, se mbi të njëjtin fakt penal dhe prova, në këtë periudhë kohore nuk ka pasur asnjë të dhënë thelbësore të dalë nga një veprimtari hetimore e plotë, që të çonte prokurorin e çështjes, në rastin konkret subjektin e rivlerësimit, në cilësimin ndryshe të veprës penale.

3.1.2 Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale, ka passjellë dhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për ndryshimin e masave të sigurisë, si rezultat i afateve të kohëzgjatjes së paraburgimit, afate të cilat me cilësimin e ri të veprave penale, janë në një shtrirje kohore prej 6 muaj, sipas nenit 263/1/b të K. Pr. Penale, duke pranuar edhe vetë subjekti se në këtë rast, ka pasur tejkalime të afateve, për arsye të pamundësisë objektive, por pa i argumentuar ato.

3.1.3 Referuar këtyre të dhënave, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, vlerëson se mangësitë e vërejtura, bien ndesh me nënindikatorët e parashikuar në nenin 73, pikat 2 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, pasi shkeljet e konstatuara në dosjet penale të trajtuara në këtë kriter, marrin kuptim dhe peshë domethënëse, në konsideratë edhe të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese.

4. Lidhur me procedimin penal nr. *, datë **.3.2018⁹**, për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës 11.7.2025, *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, vlerëson se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në analizë të situatës faktike të këtij rasi, mbeti e provuar se në dy vendimet gjyqësore të administruara¹⁰ janë konstatuar mangësi të veprimeve hetimore, për evidentimin e subjekteve përgjegjës të ngjarjes. Arsyetimi i subjektit të rivlerësimit se gjykata pas kthimit të akteve, ka pranuar dhe disponuar të njëjtin qëndrim me të, nuk qëndron, referuar dy konstatimeve të verifikueshme në arsyetimet e vendimeve gjyqësore.

4.1 *Së pari*, në drejtim të nënindikatorëve të përcaktuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, mbi *aftësinë e përgjithshme të prokurorit për të ndër marrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj*, ashtu dhe në drejtim të rezultatit përfundimtar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. *** datë **.10.2020, ka arsyetuar gjerësisht mbi nevojën e veprimeve hetimore shtesë, që duhen të kryhen nga ana e organit të akuzës¹¹.

4.2 *Së dyti*, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë edhe në vendimin nr. *** datë **.1.2021, ka konstatuar sërish mangësi hetimore, duke arsyetuar, ndër të tjera, se *organi i akuzës nuk ka marrë në shqyrtim mundësinë e përgjegjësisë penale ndaj projektuesit. Po kështu mbi pretendimet e të pandehurave se subjekti ndërtues u ka vënë në dispozicion një projekt me ndryshime, nga ana e organit të akuzës nuk është hetuar*, duke afektuar kështu dhe nënindikatorin e përcaktuar nga neni 73 pika 3 e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit.

⁹ Lidhur me këtë procedim ka patur dhe një informacion në media: https://***.***.tv/2020/02/10/vdiq-se-i-ra-vetrata-e-xhamit-ne-koke-prokurori-prej-2-vitesh-zvarrit-hetimin-kercenon-familjaret/.

¹⁰ Vendimi nr. *** datë **.10.2020 dhe Vendimi nr. *** datë **.1.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

¹¹ Komisioni ka konstatuar se nga data e regjistrimit të procedimit penal datë **.03.2018 dhe deri në datën e dërgimit të kërkesës për dërgim në çështjes në gjykim, çështja ka zgjatur dy vjet e tre muaj.

4.3 Në këto rrethana, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se gjetjet mbi këtë procedim penal, nisur dhe nga informacionet ndonëse të pakonfirmuara të përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, duhen vlerësuar në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 61/5, të këtij ligji, pasi përftohen perceptime të rëndësishme mbi integritetin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

5. Lidhur me procedimin penal nr. * datë **.6.2021, në lidhje me shtetasin *****
***, në vijim të kërkesës së Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, Kolegji i Posaçëm i Apelit, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.7.2025, ka përcjellë shkresën nr. ***/** regj., datë **.7.2025, të gjyqtarit kryesues të trupit gjykues, bashkëlidhur së cilës është përcjellë shkresa nr. *** prot., datë **.7.2025 e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë e cila në lidhje me procedimin penal ***/2021, ka përcjellë kopje të njësuara të vendimeve gjyqësore të dhëna nga kjo gjykatë në fazën e hetimeve paraprake, seancës paraprake dhe gjykimit të çështjes në themel.

5.1 Nga aktet e administruara, gjatë hetimit të Komisionit dhe ato të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, rezulton se procedimi penal ka të bëjë me ngjarjen e ndodhur në afërsi të lokalit “****”¹², në lagjen nr. ** Sarandë, ku në datë **.6.2021, janë plagosur dy shtetas. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2021, në ngarkim të shtetasve *** dhe ***
***, për veprat penale “*Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*” kundër dy ose më shumë personave, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “*Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municioneve*”, parashikuar nga neni 79/dh, 22, 25 dhe 278/1, të K. Penal.

5.2 Në datë **.6.2022, rezulton se shtetasi ***. ***, ka paraqitur pranë drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, subjektit të rivlerësimit, kërkesë për përjashtimin e prokurores së çështjes znj. *** ***, duke pretenduar për anësi në vlerësimin e çështjes dhe ngritjes së akuzës. Kjo kërkesë është protokolluar me nr. ***/** prot., datë **.6.2022, dhe ka siglimin e drejtuesit të prokurorisë/subjektit të rivlerësimit, drejtuar prokurores së çështjes, me përmbajtjen “*znj. ***/Në vlerësimin Tuaj*”. Prokurorja e çështjes, ***. ***, me vendimin e datës **.6.2022, e ka vlerësuar kërkesën të pabazuar, duke mos gjetur shkaqe ligjore për heqjen dorë nga çështja.

5.3 Në datë **.6.2022, shtetasi ***. ***, ka paraqitur sërish para drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, subjektit të rivlerësimit, kërkesë për përjashtimin e prokurores së çështjes, duke parashtruar të njëjtat pretendime si në kërkesën e datës **.6.2022. Kjo kërkesë është protokolluar me nr. ***/** prot., datë **.6.2022, dhe ka siglimin e drejtuesit të prokurorisë/subjektit të rivlerësimit, drejtuar prokurores së çështjes me përmbajtjen “*znj. ***/Më informoni mbi ecurinë e proç...*” Në vijim, prokurorja e çështjes, më datë **.6.2022, ka paraqitur drejtuesit të prokurorisë, subjektit të rivlerësimit “*Relacion mbi kërkesën për zëvendësim*”, në të cilën vlerëson sërish se kërkesa e të pandehurit është e pabazuar, por në kushtet kur

¹² https://***.com/lajm/20-plumba-drejt-pronarit-te-orange-ne-sarande-3-autoret-u-nxorren-jashte-lokalit-dhe-filluan-ta-qellojne-me-arme-spiro-iljadhi-doli-jashte-kur-degjoj-krismat

çështja paraqitet veçanërisht komplekse, e lë në vlerësimin e drejtuesit, nëse çmohet i nevojshëm zëvendësimi nga kjo çështje penale.

5.4 Në datë ***.7.2022, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, ka marrë *vendimin për zëvendësimin e prokurorit*, duke pranuar kërkesën e shtetasit ***, ***, si dhe caktimin e një prokurori tjetër që do të zgjidhet me procedurën e shortit manual. Nga aktet rezulton se shorti është zhvilluar në datë **.7.2022, short nga i cili është zgjedhur subjekti i rivlerësimit.

5.5 Prokurorja znj. ***, ***, në datë **.7.2022, ka nënshkruar deklaratë për heqjen dorë dhe nga hetimi i procedimit penal nr. ***/2022, që përmban akte të cilat shërbejnë për identifikimin e personave të tjerë të dyshuar për ngjarjen për të cilën është regjistruar procedimi penal nr. ***/2021.

5.6 Në Vendimin nr.***, datë **.6.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me kërkuar Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, përfaqësuar nga Prokurore *** ***, me objekt *“Zgjatjen për një periudhë 3 muaj të ****tit të paraburgimit, deri në datën **.9.2022 për shtetasin ***,***.”*, kërkesë e cila është rrëzuar nga Gjykata, rezulton se prokurorja e çështjes znj. *** ***, është shprehur se: [...] *Hetimet e këtij procedimi penal janë përfunduar dhe është komunikuar akuza dhe njoftimi i përfundimit të hetimeve të pandehurve më datë **.06.2022, konkretisht për veprat penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municioneve”, të parashikuar nga neni 76, 22, 25 dhe 278/1, të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit *** *** dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municioneve”, të parashikuar nga neni 278/1, të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit *** ***. I pandehuri *** *** ka treguar që nuk është dakord me akuzën që është bërë dhe për këtë arsye ai, së bashku me mbrojtësin e tij av.*** *** kanë refuzuar të firmosin aktet e komunikuar. Në këtë mënyrë, organi procedues përveç faktit që ia komunikoi, gjithashtu ua dërgoi dhe me anë të shërbimit postar [...]*

5.7 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në datë **.9.2022, pa kryer vetë asnjë veprim hetimor ka paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, dy kërkesa:

(1) *“Për dërgimin e çështjes në gjyq të procedimit penal nr. 364/2021” për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municioneve”, parashikuar nga neni 278/1 të K. Penal në ngarkim të pandehurve *** ***, dhe *** ***, duke arsyetuar, ndër të tjera, se “Mbi bazën e veprimeve sa më sipër, prokurori i çështjes ka formuluar akuzë ndaj shtetasit *** ***, duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municioneve”, parashikuar nga neni 76, 22,25 dhe 278 i K. Penal. Akti i njoftimit të akuzës dhe marrjes si të pandehur ndaj shtetasit *** ***, rezulton i paqartë dhe madje i paplotë.”*

(2) *“Kërkesë për pushimin e pjesshëm të akuzës”, në funksion të çështjes penale nr. 364/2021, në ngarkim të pandehurit *** ***, për veprën penale “Vrasja me dashje”, e*

mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76-22 dhe 25 të K. Penal.

5.8 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me vendimin e datës **.7.2023 të gjyqtarit paraprak, sa i takon kërkesës së subjektit të rivlerësimit lidhur me dërgimin e çështjes në gjyq, ndër të tjera, ka arsyetuar se [...] Gjykata vlerëson se në rastin konkret, hetimet e kryera nga organi i Prokurorisë nuk janë të plota. Prokuroria nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në kuadër të grumbullimit të provave, për të provuar faktin penal në ngarkim të të pandehurve... duke qenë se nga ana e organit të akuzës nuk janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në funksion të zbardhjes së të vërtetës, çështja duhet ti kthehet Prokurorisë, me qëllim thellimin e hetimeve [...].

5.8.1 Ndërsa, sa i takon kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit *** ***, Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar se [...] E gjen të paparanueshme kërkesën e Prokurorisë për pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit *** *** për veprën penale të parashikuar nga neni 76, në raport me nenet 22 e 25 të K.Penal. Kjo pasi, tentativa e vrasjes dhe armëmbajtja pa leje duke qenë fakte të lidhura ndërmjet tyre, nuk mund të hetohen veçmas, për aq sa provat e grumbulluara në funksion të vërtetimit të njërit fakt, lidhen ngushtësisht edhe me faktin tjetër. Gjykata vlerëson se nuk duhet të pranojë kërkesën për pushimin e akuzës për aq sa në rastin konkret ka vend për hetime, jo vetëm në funksion të provueshmërisë së faktit penal, por edhe në drejtim të zbulimit të të gjithë autorëve të mundshëm, përfshirë dhe ata që kanë mbetur të paidentifikuar nga prokuroria, me qëllimin më pas edhe individualizimit të përgjegjësisë penale respektive [...].

5.8.2 Sa më sipër Gjykata, ka vendosur: (i) Kthimin e çështjes penale me nr.***-***-***-2023/***/** regj. them., datë regjistrimi **.9.2022, të regjistruar pranë kësaj Gjykate lidhur me procedimin penal nr.***, të vitit 2021, me të pandehur *** *** dhe *** ***, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë për plotësim të hetimeve paraprake, sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi; (ii) Veprimet proceduriale për plotësimin e hetimeve paraprake, lidhur me procedimin penal ***, të vitit 2021 duhet të përfundojnë brenda një ***ti 4 (katër) mujor.

5.9 Në vijim, rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me vendimin e datës **.10.2024, pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pushimin e pjesshëm të akuzës në ngarkim të të pandehurit *** *** për veprën penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim, së bashku me dërgimin e çështjes në gjyq, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë Sarandë dhe pushimin e akuzës “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76, 22 dhe 25 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit *** ***, në kuadër të procedimit penal nr.366, të vitit 2021 të Prokurorisë Sarandë.

5.10 Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të procedimit penal ***/2021 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar (i) Deklarimin fajtor të të pandehurit *** ***. për

kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal dhe dënimin nga Gjykata me 6 vite burgim. Në llogaritjen e masës përfundimtare të dënimit, Gjykata të ketë në vemendje aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale; (ii) Deklarimin fajtor të të pandehurit *** ** për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal dhe dënimin nga Gjykata me 6 vite burgim. Në llogaritjen e masës përfundimtare të dënimit, Gjykata të ketë në vemendje aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale; Në aplikim të nenit 59 të K.Penal, për shkak të gjendjes shëndetësore të të pandehurit ekzekutimi i vendimit të dënimit për pjesën e mbetur të pezullohet dhe i pandehuri të vihet në provë për një afat sa dyfishin e masës përfundimtare të dënimit me kusht që gjatë kësaj periudhe mos të kryej vepër tjetër penale.

5.11 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me vendimin nr. **-2024-*** (***), datë **.11.2024, i formës së prerë¹³, ndër të tjera, ka vendosur: (i) Deklarimin fajtor të të pandehurit *** **. për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal dhe dënimin e tij me 6 vite burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale i ulet 1/3 e dënimit dhe si përfundim i pandehuri *** **. dënohet me 4 vite burgim¹⁴ (ii) Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit *** ** i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal.

5.12 Sa më sipër, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, vlerëson se nga vendimet gjyqësore të administruara dhe konkretisht vendimi i datës **.7.2023 janë konstatuar mangësi të veprimeve hetimore, në funksion të provueshmërisë së faktit penal, por edhe në drejtim të zbulimit të të gjithë autorëve të mundshëm të përfshirë, gjetje të cilat duhet të vlerësohen në drejtim të nënindikatorëve të përcaktuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, mbi *aftësinë e përgjithshme të prokurorit për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj*, ashtu dhe në drejtim të rezultatit përfundimtar.

5.12.1 Nga vlerësimi i përmbajtjes së akteve të administruara rezulton se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes, pa kryer veprime hetimore shtesë që mund të ndryshonin në provueshmërinë e fakteve të çështjes, ka paraqitur në datën 19.09.2022 kërkesën për pushimin e akuzës për veprën penale “Vrasja me dashje”, të mbetur në tentativë, në ngarkim të të pandehurit *** **, ndërkohë që prokurorja e mëparshme për të njëjtin fakt në datën 13.06.2022 kishte vendosur njoftimin e akuzës ndaj të pandehurit *** ** për veprën penale “Vrasja me dashje”, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal.

¹³ Vendimi ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar nga palët..

¹⁴ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me vendimin nr. **-2024-***, datë **.12.2024, ka vendosur shuarjen e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, caktuar ndaj shtetasit *** ** pasi rezulton se kërkuesi e ka vuajtur të plotë dënimin e dhënë me vendimin nr. **-2024-*** (***), datë **.11.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, pasi kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se masa e dënimit të caktuar.

5.12.2 Në këto rrethana, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vlerëson se gjetjet mbi këtë procedim penal, nisur dhe nga informacionet të përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, duhen vlerësuar në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 61/5, të këtij ligji, pasi përftohen perceptime të rëndësishme mbi integritetin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

III. Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

6. Lidhur me denoncimin e shtetasit * ***¹⁵. Procedimi penal nr. *** datë **9.2019,** për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës **7.2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, vlerëson se edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës lidhur me (i) kohëzgjatjen e hetimit prej 1 vit e 6 gjashtë muaj dhe mungesën e veprimeve hetimore në intervale kohore nga 9 muaj dhe 5 muaj; (ii) Pas vendimit nr. *** datë **05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga ana e prokurorit nuk është kryer akt-ekspertimi me qëllim përcaktimin nëse ndërhyrjet janë bërë nga shtetasi ***. ***, veprim i cili është kërkuar edhe nga ana e të pandehurit; (iii) Mungesën e kryerjes së veprimeve hetimore për një periudhë rreth 10 mujore, në kundërshtim me vendimin e formës së prerë nr. *** datë ***05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka vendosur plotësimin e hetimeve brenda 3 muajve.

6.1 Sa më sipër, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, lidhur me shkakun e ankimit të mësipërm, dhe me vlerësimin në terësi të çështjes, vërejmë se në rastet kur gabimet e subjekteve të rivlerësimit evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe duhet të vlerësohen negativisht¹⁶. Ashtu sikurse ka orientuar Kolegji në jurisprudencën e tij, çmon se këto gjetje, duhen vlerësuar në funksion të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me parashikimet e nenit 61, pika 5, e të njëjtit ligj.

7. Lidhur me denoncimin e shtetasit * *** dhe të tjerë¹⁷. Procedimi penal nr. *** datë ***9.2015,** për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës **7.2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, vlerëson se edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, dhe qëndrojnë pretendimet e denocuesit në raport me mungesën e akuzës së ngritur ndaj shtetasit ***. ***, dhe ***tit të tejzgjatur të çështjes. Subjekti dhe në këtë rast, më së paku, tregoi mangësi në efikasitetin hetimor, lidhur me ndërmarjen e hetimit sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe për të përballuar ngarkesën e punës.

7.1 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, dhe në rastin konkret vlerëson se ka rrethana, të cilat duhen vlerësuar në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të analizimit të nënindikatoreve të përcaktuar nga neni 73/2 dhe 74/1 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

¹⁵ Referohuni denoncimit nr. *** prot., datë **04.2019 në dosjen e Komisionit.

¹⁶ Referohuni vendimit nr. 2/2020 të Kolegjit, prg. 32.5.

¹⁷ Referohuni denoncimit nr. *** prot., datë ***10.2019, në dosjen e Komisionit.

8. Lidhur me etikën dhe profesionalizmin referuar nenit 75/4 të ligjit nr. 96/2016, konkretisht lidhur me mardhënien me shoqërinë “****” konstruksion sh.p.k dhe administratorin e saj z. *** ***, subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *mardhënia e posedimit pa kundërshtpërblim e apartamentit në pronësi të shtetasit *** ***, ka qenë personale, faktike dhe verbale, pa implikime juridike me shoqërinë ndërtuese ... nuk ekziston asnjë element përbërës i një konflikti intersi, as real as të perceptuar sipas standarteve të ligjit dhe jurisprudencës mbi këtë aspekt [...].*

8.1 Sikurse është trajtuar gjerësisht në ankim dhe në parashtimet e seancës gjyqësore datë 11.7.2023, rezulton se shtetasi *** ***, me kërkesën të datës **.7.2017, i ka kërkuar Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, zëvendësimin e prokurorit të çështjes/subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, duke argumentuar se [...] *Rezulton se në objektin e banimit 8-katësh, i cili ndodhet përbri dy objekteve të ndërtuara nga subjekti ndërtues “**** **”, ka marrë një banesë me qera përpara rreth tre muajsh shtetasi Kledian Llaho, i cili rezulton të jetë edhe prokurori i çështjes, që është duke hetuar kallëzimin penal të bërë nga shtetasi ***, ***, për të cilin është regjistruar kallëzimi penal nr. ***/2016. Ky shtetas, vetëm pak ditë pasi ka filluar të banojë në banesën e marrë me qera, është paraqitur tek ambientet e subjektit ndërtues dhe më është prezantuar si prokuror, pasi ra në dijeni se isha administratori i subjektit ndërtues, të hiqja antenën e kompanisë ..., e cila është vendosur në tarracën e njërit prej objekteve të ndërtuar nga subjekti ndërtues “**** **.” [...].*

8.1.1 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me vendimin e datës **.7.2017, ka pranuar kërkesën e shtetasit *** ***, për zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit nga hetimi i mëtejshëm i procedimit penal nr. ***/2016, ndër të tjera, duke arsyetuar se [...] *Nga të dhënat e mësipërme, **rezulton se ndërmjet kërkesit dhe prokurorit të çështjes ekziston një mosmarrëveshje** ... Në këto kushte del e qartë se ndodhemi para një shkak ligjor për zëvendësimin e prokurorit. [...]* E njëjta situatë dhe e njëjta arsye konflikti, ka shërbyer për zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit dhe në procedimin penal nr. ***/2017, me kërkesën e shtetasit *** ***,.

8.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në analizë të situatës faktike të përshkruar më sipër, vlerëson se në konsideratë të pretendimeve të subjektit se nuk ka patur një interes pasuror me shtetasin *** ***, përsëri çmojmë se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar diligjencën e duhur për konstatimin e gjendjes së konfliktit të interesit, në kushtet kur mes tij dhe shtetasit ***, ***, ka ekzistuar një mosmarrëveshje e konstatuar në të paktën dy raste dhe nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

8.3 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, vlerëson se dhe në rastin konkret ka vend vlerësimi nga ana e Kolegjit lidhur me nënindikatorët e përcaktuar nga neni 75/4 i ligjit nr. 96/2016, lidhur me kujdesin e treguar ndaj konfliktit të interesit.

9. Në përfundim të vlerësimit të vendimit nr. 607/2022 të Komisionit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ashtu sikurse dhe Kolegji ka arsyetuar në jurisprudencën e tij¹⁸, parë nga këndvështrimi i publikut, konstaton gjendjen e cënimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, z. Kledian Llaho, mbi bazën e një analize të detajuar sa më sipër, që mori në konsideratë (i) mangësitë në kontrollin e pasurisë; (ii) informacionet e organeve ligjzbatuese; (iii) denoncimet nga publiku dhe gjetjet në aspektin profesional; (iv) mungesa e dilijencës së duhur për konstatimin e gjendjes së konfliktit të interesit.

9.1 Në përmbledhje të sa më sipër, në analizë të problematikave të konstatuara, në një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve të rivlerësimit dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave sipas parashikimit të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cënimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e këtij ligji.

IV. Kërkimi i ankimit

10. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

11. Bazuar në nenin Ç, E, D, DH dhe F, të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI dhe nenin 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016;

12. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kledian Llaho.

DREJTUESI I PROKURORISË SË POSAÇME

Altin DUMANI

¹⁸ Referuar vendimit (JR) nr. 11/2022, të Kolegjit, prg. 43-44.